



Prishtinë, 24.06.2022  
Kodi i ZRRE-së: V\_1540\_2022

## Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

### Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK\_V\_2296\_04\_22** i dt.01.04.2022;
- Kundërshtimi i KESCO-s i datës **29.04.2022**;

në seancën e mbajtur më datë **24.06.2022** nxori këtë:

### V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kundërshtimi i KESCO-s ndaj vendimit të DMK-së, për konsumatorin S.A nga komuna e Podujevës, si e pabazuar.
- II. **MBETET në fuqi**, vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE, me nr. ZRrE/DMK\_V\_2296\_04\_22, i datës 01.04.2022.

### A r s y e t i m

Departamenti për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRrE, me datë 01.04.2022 ka marrë Vendim me nr. ZRrE/DMK\_V\_2296\_04\_22 me të cilin e ka aprovuar ankesën e palës dhe e ka obliguar KESCO-n që të anulohet korrigjimin plotësues nr. 97979DPR-68798 datë 16.06.2021 në vlerë **1,722.05€** si dhe të korrigjohet faturat 10/2016 - 02/2020 në vlerë **-206.87€**.

I pakënaqur me Vendimin e DMK-së, i licencuari KESCO, brenda afatit ligjor ka paraqitur Kundërshtim në Bordin e ZRrE-së, për këto shkaqe:

- Faturimi plotësues i datës 02.04.2021 për periudhën 07/2018 deri 02/2020 është i saktë dhe është bërë sipas gjendjeve të regjistruara në njehsor dhe duke u bazuar në protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.4419 të datës 14.01.2021.
- Bazuar në të dhënat teknike nga AMR shihet se njehsori me nr.32630280 ka regjistruar energjinë elektrike sipas të dhënave nga faktorët teknik, rrymat dhe tensionet përkatëse për periudhën 10/2016 deri 06/2018 si dhe faturimi a qenë në mënyrë të rregullt në baza mujore.
- Duke u bazuar nga të dhënat e njehsorit të ri nr.54384779 shihet se konsumatori ka shpenzime të përafërta dhe në disa periudha më të larta, sesa llogaritja e KËh për periudhën 07/2018 deri 02/2020. Sipas rrjedhës së energjisë mujore të konsumit të energjisë elektrike shihet se



shpezimi për muajin 12/2020 ka qenë 3653.59 kWh, në muajin 01/2021 ka qenë 4159.29 kWh, për muajin 02/2021 ka qenë 3057.99 kWh dhe për muajin 04/2021 shpenzimi ka qenë 3862.08 kWh. Gjithashtu për muajin 12/2021 kanë qenë të shpenzuara 3990.44 kWh, në muajin 01/2022 kanë qenë të shpenzuara 3338.04 kWh dhe për muajin 04/2022 kanë qenë të shpenzuara 2701.25 kWh. Sipas kësaj mund të vërehet se nuk ka diferenca të mëdha në mes të kWh të faturuar nga ana e KESCO-s për njehsorin e vjetër me shpenzimin e njehsorit të ri.

- Apeluesi KESCO kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të pezullojë vendimin e DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2296\_04\_22 i datës 01.04.2022 për konsumatorin S.A.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest, si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkallës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Lidhur me pretendimin se faturimi për periudhën 07/2018 deri 02/2020 është i saktë, ZRrE thekson se pas analizimit të të gjitha shkresave të lëndës, si : Ankesa e konsumatorit në KESCO e datës 10.02.2020; Procesverbali mbi ndërrimin dhe heqjen e njehsorit elektrik nr.0834178 i datës 26.02.2020; Protokollin i shqyrtimit të njehsorit elektrik nr.org.02 Nr.4419 datë 16.03.2021; Rrjedha e energjisë elektrike; Përgjigja e KESCO-s e datës 18.06.2021; Ankesa e konsumatorit në DMK të ZRrE-së e datës 08.07.2021; Vendimi i DMK-së ZRRE/DMK\_V\_2296\_04\_22 i datës 01.04.2022 dhe Kundërshtimi i KESCO-s i datës 29.04.2022, gjeti se ky pretendim nuk qëndron si i tillë, sepse nga të gjitha provat e përmendura më lartë, pa mëdyshje vërtetohet se leximi i fundit i shpenzimeve ka qenë në periudhën 06/2018 ku TL=38,733 kWh dhe TU=19,139 kWh e që edhe kjo gjendje e faturimit bazuar edhe në krahasimet e shpenzimeve të më vonshme nuk përputhët me gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 4419 datë 16.03.2021, ku TL=039419 kWh dhe TU=090151 kWh, me çka edhe vërtetohet se konsumatori nuk ka lexim të saktë të shpenzimeve.

Në një vështrim kronologjik të rastit, ZRrE gjen se, fillimisht me datë 26.02.2020 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori kanë inspektuar piken matëse të konsumatorit ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr. 32630280 , nuk është evidentuar gjendja e shpenzimeve pasi nuk ka pasur tension-pa furnizim, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr. 54384779 me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Ekipi i KEDS-it ka evidentuar se njehsori i ri vendoset në shtyllë kurse njehsori i vjetër duhet të dërgohet në qendrën e kalibrimit për shqyrtim. Me datë 08.10.2020 punëtorët e autorizuar të qendrës së kalibrimit kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes të njehsorit elektrik nr. 32630280 me gjendje të shpenzimeve TL=039419 kWh dhe TU=090151 kWh ku kanë konstatuar se: njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori elektrik dëmtime nuk ka si dhe gabimi në matje është +0.61%. Më tutje, departamenti i faturimit në KESCO me datë 16.06.2021 e ka ngarkuar konsumatorin me korrigjim plotësues nr. 97979DPR-68798-68798 në vlerë financiare **1,722.05€** duke bërë korrigjimin plotësues për faturat e periudhës 07/2018-02/2020. Bordi i ZRrE-së ka shqyrtuar korrigjimin plotësues të bërë nga Departamenti i faturimit në KESCO dhe konstaton se KESCO ka gabuar pasi që duke marr parasysh se konsumatori nuk ka pasur lexim të saktë



të shpenzimeve nga fillimi atëherë shpërndarja e kËh te faturuara është dashur të bëhet nga fillimi, përkatësisht periudha 10/2016 kur edhe është vendosur për matje njehsori nr. 32630280 deri në periudhën 02/2020 kur edhe është larguar nga matja.

ZRrE është ndalur edhe në analizimin e rrjedhës së energjisë elektrike, ku për më tepër vërtetohet se konsumatori nga periudha 07/2018 deri me ndërrimin e njehsorit datë 26.02.2020 është faturuar pa matje në mënyrë të vlerësuar. Mos qasja në leximin e shpenzimeve mujore është në kundërshtim me nenin 25 paragrafin 1 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji, e ku thuhet se:1. *“Konsumatori është i obliguar që të ju lejojë qasje në pronën e tij, përfaqësuesve të Operatorit të Sistemit/Furnizuesit, për qëllim të leximit, testimit, inspektimit, instalimit, mirëmbajtjes, riparimit të matësve, kyçjeve dhe pajisjeve përkatëse ashtu si paraqitet në Nenet 28, 29 dhe 30 të Ligjit për Energji”*. Sipas analizës së rrjedhës së energjisë elektrike konstaton se leximi i fundit i shpenzimeve ka qenë në periudhën 06/2018 ku TL=38,733 kWh dhe TU=19,139 kWh e që edhe kjo gjendje e faturimit bazuar edhe në krahasimet e shpenzimeve të më vonshme nuk përputhet me gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në protokollin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 4419 datë 16.03.2021, ku TL=039419 kWh dhe TU=090151 kWh.

Bordi i ZRrE-së bazuar në analizën e përgjithshme të energjisë elektrike me njehsorin e vjetër elektrik si dhe njehsorin e ri elektrik konstaton se konsumatori nuk ka lexim dhe faturim të rregullt të shpenzimeve mujore dhe se lexuesi në shumicën e periudhave ka evidentuar se nuk ka qasje në leximin e pikës matëse. Gjithashtu Bordi ka bërë shqyrtimin e kWh të evidentuar në procesverbalin e shqyrtimit të njehsorit elektrik Nr.org.02Nr. 4419 datë 16.03.2021, përkatësisht periudha 10/2016 deri në periudhën 02/2020 dhe konstaton se konsumatorit duhet ti bëhet korigjimi në vlerë **-206.87€**.

Bordi i ZRrE, gjithashtu ka konstatuar se përfaqësuesi i autorizuar i KESCO-së në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se e ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar, pa ofruar prova të arsyeshme.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 24.06.2022 pas analizimit të gjithë asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



**Këshillë Juridike:** Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

**Bordi i ZRRE-së:**

---

Ymer Fejzullahu, Kryesues

---

Selman Hoti, anëtar

---

Izet Rushiti, anëtar

---

Lutfije Dervishi, anëtare

---

Gani Buçaj, anëtar

**Vendimi u dërgohet:**

- KESCO-s,
- Konsumatorit S.A dhe
- Arkivit të ZRRE-së.